

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, neni 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) nr.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/5 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe të nenit 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 mars 2025, episodet e serialeve artistike: Nënë (Majka)“, „Merjem“ dhe „Tradhëtia (Неверство)“, të shënuara si programe të kategorisë së tretë (12+) janë transmetuar në periudhë të papërshtatshme kohore të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, certifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet nëse është kryer shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara

mbi bazën e Ligjit të njëjtë si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose të ritransmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve me kërkesë, duhet të marrin masa teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të jenë të mbrojtur nga përmbajtje të dëmshme si dhuna e tepruar dhe pornografi. Përveç programeve nga paragrafi (1) të këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos mundë t'i shohin ose dëgjojnë programet. Nëse programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv është i detyruar që para transmetimit të tyre të ofrojë paralajmërim paraprak akustik dhe mundësinë për t'i njohur me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 të LSHMAAV).

Në nenin 16 të RRMPM është parashikuar periudha kohore për kategorinë e programeve, në të cilën parashihet se në varësi të përbërjes së pritshme të publikut, kategoritë e programeve mund të transmetohen në periudhat kohore në vijim: Programe të kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditë-natës; kategoria e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00; Kategoria e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00; Kategoria e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore më 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, nga ku është konstatuar shkelje e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 16 (periudha kohore për kategoritë e programeve) nga RRMPM, të mënyrës që në shërbimin programor të datës 4 mars 2025, episodet e serialeve artistike: „Nënë (Majka)“, „Merjem“ dhe „Tradhëtia (Неверство)“, të shënuara drejtë si programe të kategorisë së tretë (12+) janë transmetuar në periudhë kohore të papërshtatshme të shërbimit programor.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Rapotin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, me datë 28.03.2025, dërgoi Shkresë ark.nr.10-1369/2 datë 28.03.2025, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 01.04.2025. Në afatin e parashikuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim, konkludoi që SHTR KLAN MAQEDONI SPOKNJP eksport-import Saraj Shkup t'i shqiptojë masë – vërejte publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, neni 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) nr.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/5 datë 10.04.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të

harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programe, ark.nr.10-1369/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,
d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.